THE HISTORIAN LUDWIG THALLÓCZY AND HIS CONTRIBUTION TO THE RECOGNITION OF THE IDENTITY AND HISTORY OF THE ARBANASI OF ZADAR

HISTORIANI LUDWIG THALLÓCZY DHE KONTRIBUTI I TIJ NË NJOHJEN E IDENTITETIT DHE HISTORISË SË ARBNESHËVE TË ZARËS

Murat AJVAZI

Association of Albanian Historians Worldwide, based in Switzerland

Abstrakti

Shumë historianë evropianë kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në studimin dhe njohjen e identitetit, historisë dhe kulturës së arbneshëve të Zarës, në Kroaci. Ndër ta shquhet historiani Ludwig von Thallóczy, një njohës i mirë i historisë së popujve të Ballkanit dhe, në veçanti, i historisë së arbneshëve të Zarës.
Në punimin e tij me titull „Die Albanische Diaspora“, të botuar në veprën „Illyrisch-Albanische Forschungen“, në vitin 1916, në Lajpcig, në vëllimin e dytë, në faqet 299–341, Thallóczy trajton në mënyrë të hollësishme vendosjen e arbneshëve në Borgo Erizzo të Zarës. Ai paraqet të dhëna me rëndësi për qytetin e Zarës, rrethinën e tij, vendbanimet dhe procesin e shpërnguljes e të vendosjes së arbneshëve.
Përmes dokumenteve historike dhe publikimeve evropiane, autori sjell dëshmi me vlerë për historinë e diasporës shqiptare dhe për përpjekjet e arbneshëve për ruajtjen e gjuhës, kulturës, traditave dhe zakoneve të tyre.
Qëllimi i këtij punimi është të analizojë kontributin e Thallóczy-t në dokumentimin dhe promovimin e identitetit arbnesh, si dhe ndikimin e studimeve të tij në zhvillimin e albanologjisë dhe në afirmimin e kulturës arbneshe në qarqet akademike evropiane.
Në përfundim, shpreh mirënjohjen time të veçantë për Universitetin e Tetovës dhe organizatorët e tjerë për organizimin e kësaj konference shkencore, kushtuar historisë dhe trashëgimisë së arbneshëve të Zarës.

Abstract

Many European historians have made significant contributions to the study and recognition of the identity, history, and culture of the Arbanasi of Zadar, Croatia. Among them, the historian Ludwig von Thallóczy stands out as a distinguished scholar of the history of the Balkan peoples and, in particular, of the history of the Arbanasi of Zadar.
In his study entitled “Die Albanische Diaspora”, published in the work “Illyrisch-Albanische Forschungen” in Leipzig in 1916, Volume II, pages 299–341, Thallóczy provides a detailed account of the settlement of the Arbanasi in Borgo Erizzo, Zadar. He presents valuable information about the city of Zadar, its surrounding areas, settlements, and the process of migration and settlement of the Arbanasi community.
Drawing on historical documents and European publications, the author provides valuable evidence concerning the history of the Albanian diaspora and the efforts of the Arbanasi to preserve their language, culture, traditions, and customs.
The aim of this paper is to analyse Thallóczy’s contribution to documenting and promoting Arbanasi identity, as well as the influence of his research on the development of Albanian studies and the recognition of Arbanasi culture within European academic circles.
Finally, I would like to express my special gratitude to the University of Tetova and the other organisers for organising this scientific conference dedicated to the history and heritage of the Arbanasi of Zadar.

Hyrje

Historia e diasporës shqiptare në hapësirën evropiane përbën një nga fushat më interesante të studimeve historike, etnografike dhe kulturore. Në këtë kuadër, vend të veçantë zë komuniteti i arbëneshëve të Zarës, i cili, pavarësisht largimit nga trojet e origjinës, arriti të ruajë për një periudhë të gjatë elemente të rëndësishme të gjuhës, traditës, identitetit, kujtesës familjare dhe përkatësisë kulturore.

Një nga studiuesit që u interesua për këtë komunitet dhe për historinë e diasporës shqiptare ishte historiani hungarez Ludwig (Lajos) Thallóczy (1856–1916). Emri i tij lidhet ngushtë me zhvillimin e albanologjisë në hapësirën austro-hungareze, me hulumtimin e dokumenteve mesjetare dhe me përpjekjet për ta paraqitur historinë shqiptare në qarqet shkencore evropiane.[1]
Interesimi i Thallóczy-t për arbëneshët e Zarës nuk ishte një çështje e shkëputur nga veprimtaria e tij e përgjithshme shkencore. Ai e shihte diasporën shqiptare si pjesë të një hapësire më të gjerë historike dhe kulturore, e cila dëshmonte për vazhdimësinë e lidhjeve ndërmjet shqiptarëve të vendosur në vende të ndryshme të Evropës dhe trojeve të tyre të origjinës.
Në këtë aspekt, studimi i tij Die Albanische Diaspora (Diaspora shqiptare), i botuar në vitin 1916 në përmbledhjen Illyrisch-Albanische Forschungen, paraqet një burim me rëndësi për njohjen e emigrimeve, të familjeve shqiptare, vendbanimeve të tyre jashtë atdheut. Në këtë studim ai trajtoi disa komunitete shqiptare, ndër të cilat edhe arbëneshët e Borgo Erizzo-s dhe Zemunik pranë Zarës.[2] Emërtimi Borgo- Erizzo u detajua nga vetë autori.
Ludwig (Lajos) Thallóczy ishte historian hungarez, arkivist dhe studiues i historisë së Evropës Juglindore dhe popujve të Ballkanit e në veçanti ishte studiues i toponimeve, gjuhës, kulturës, histories etj. Ai lindi në Budapest më 8 dhjetor 1856 dhe vdiq më 1 dhjetor 1916, në një aksident hekurudhor pranë Herczeghalomit. Gjatë jetës së tij ushtroi veprimtari në institucione të rëndësishme shkencore dhe administrative të Monarkisë Austro-Hungareze.[3]
Thallóczy bashkëpunoi me studiues të njohur të kohës, ndër të cilët Konstantin Jireček dhe Milan Šufflay. Një prej ndërmarrjeve më të rëndësishme të këtij bashkëpunimi ishte përgatitja e veprës dokumentare Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia, e cila përmban dokumente me rëndësi për historinë mesjetare shqiptare.[4]
Thallóczy nuk u kufizua vetëm në historinë politike dhe mesjetare. Ai u interesua edhe për historinë e diasporës shqiptare, për vendbanimet e saj, për zhvillimin e komuniteteve dhe për lidhjet e tyre me botën shqiptare.

Arbëneshët e Zarës – prejardhja dhe vendosja në Dalmaci

Arbëneshët e Zarës përfaqësojnë një komunitet historik shqiptar, i cili u vendos në Dalmaci gjatë të shekujve XV -XVII. Vendbanimi i tyre u njoh me emrin Borgo Erizzo, ndërsa sot njihet si Arbanasi, në qytetin e Zarës, në Kroaci.
Shpërngulja e shqiptarëve drejt kësaj hapësire duhet parë në kontekstin e rrethanave të ndërlikuara politike, ekonomike dhe fetare të fundit të shekullit XV - XVIII. Në këtë proces ndikuan luftërat, pasiguria, vështirësitë ekonomike dhe presionet që përjetonin popullsitë e disa krahinave shqiptare.
Sipas hulumtimit të Edmond Malajt, një pjesë e rëndësishme e familjeve që u vendosën në Zarë, kishin prejardhje nga Shestani, Brisku dhe treva të tjera të lidhura me dioqezën e Shkodrës. Në vendosjen dhe sistemimin e tyre në Zarë rol të rëndësishëm pati argjipeshkvi Vicko Zmajević.[5]
Krijimi i kolonisë së Borgo Erizzo-s shënoi fillimin e një etape të re në historinë e këtyre familjeve. Ato u vendosën në një mjedis të ri shoqëror, por ruajtën për një kohë të gjatë lidhje me prejardhjen, gjuhën dhe traditat e tyre.
Sipas Edmond Malajt, popullsia e Borgo Erizzo-s u rrit ndjeshëm gjatë shekujve XVIII dhe XIX. Në vitin 1726 aty përmenden 56 shqiptarë të sapoardhur, ndërsa për vitin 1880 jepet shifra prej rreth 2.000 banorësh.[6]

Interesimi i Thallóczy-t për arbëneshët e Zarës

Në studimin Die Albanische Diaspora, Thallóczy paraqiti historinë e disa vendbanimeve shqiptare në Evropën Qendrore dhe Juglindore. Ndër to përfshiu shqiptarët e Sremit, komunitetin e Petrovaradinit, arbëneshët e Borgo Erizzo-s dhe arbëreshët e Italisë.[7]
Kjo qasje dëshmon se ai nuk e shihte historinë shqiptare vetëm brenda kufijve gjeografikë të Shqipërisë, por edhe përmes shpërnguljeve, vendosjeve dhe zhvillimit të komuniteteve shqiptare në hapësira të tjera.
Në mënyrë të përmbledhur, autori përshkruan vendin ku u vendosën arbëneshët në Borgo Erizzo. Ndër të tjera, ai thekson: "Në jug të Zarës, përgjatë Parkut elegant Bllazekoviq dhe zonës së stërvitjes ushtarake, shtrihet periferia e Borgo Erizzos. Në thelb, është një fshat dy kilometra i gjatë, 0.5 km i gjerë, që zë kepin midis kanalit të Zarës dhe Valle di Borgo. Një sërë shtëpish njëkatëshe, të rrethuara me ndërtesa shumëkatëshe në stilin Italian, shtrihen përgjatë bregut, pamja e tyre e jashtme mezi ndryshon nga qytete të tjera të vogla përgjatë Bregdetit Adriatik.
Ky vend banohej nga shqiptarët, të cilët, sipas përshkrimit të autorit, ende flisnin gjuhën e tyre amtare dhe ruanin kujtimin e prejardhjes.8
Vendosja e këtyre njerëzve në Zarë dhe zonën përreth saj quhet Arbanasi. Kjo shpërngulje nuk ndodhi siç thonë disa studiues në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, por edhe më herët. Më 1665 kapiteni shqiptar Nikolo Ceclina, i cili udhëhoqi një grup prej 100 emigrantësh shqiptarë, të përbërë nga 50 familje në Istria, gjeti një vend të përshtatshëm për popullin e tij. Në peticionin e tij ai kërkoi lëshimet e mëposhtme nga guvernatori i atëhershëm i Dalmacisë Antonio Zen: që popullit të tij t'u jepen të njëjtat liri të cilat i gëzonin banorët e Zhupës, për më tepër, ai kërkoi ndihmë materiale dhe lirinë për ta praktikuar fenë e tyre.9
Gjatë viteve 1723 – 1726 konti Nicholo Erizzo II i cili sundoi në Dalmaci, kur u informua nga Zmajeviq se arbanasit (shqiptarët krishterë) kërkonin strehim, ai bëri gjithçka që varej prej tij për t'u dhënë atyre tokë të përshtatshme. Vetë qyteti i Zarës kishte nevojë për ushtarë, punëtorë. Ky guvernator i mirëpriti me kënaqësi 18 familje shqiptare që numëronin 147 familjarë dhe e bindi Atin Giojanni Greisogono (një patrik nga Zara) të dhuronte pronën e tij prej 160 kamposh (një kamposh sipas masës padovane ishte ekuivalent me 1016 fathomë katrorë vienez) që ndodhej pranë Zarës për qëllime vendosjeje, në konsideratë të premtimeve të caktuara. Grupi i emigrantëve u vendos këtu pas matjeve paraprake dhe në këtë kohë Kolonia u quajt Borgo Erizzo. Qeveria provinciale menjëherë ndërtoi banesa të përbashkëta me një shtallë dhe hambar për bagëtinë e tyre dhe u garantoi atyre lirim nga pagesa e taksave, përveç taksës së dhjetës. Nga 15 gushti 1726 ata fituan gjithashtu një shkallë të caktuar përparësie duke qenë të varur nga një kapiten (knez) i vetëzgjedhur, i cili përfaqësonte interesat e tyre te guvernatori. Kapiteni emëroi gjithashtu udhëheqësit e fshatit .10
Mbikëqyrja e kapitenit përfundoi më 1759 kur u vunë nën komandën e kolonelit të Zarës. Përveç kolonisë së Borgo Erizzos, disa familje nga Shqipëria u vendosën gjithashtu në Zemonik, 12 km larg sipas të njëjtave kushte që iu dhanë atyre në Zarë. Më 1727, 7 familje me 71 anëtarë u vendosën në Zemunik të përcjella edhe nga 28 familje të tjera me 150 anëtarë gjatë vitit 1733.11
Më 1737 Omer Pasha i Antivarit (Tivarit) i detyroi të krishterët vendës të iknin për shkak të keqtrajtimit të tij më se të ashpër.Emo, udhëheqësi i Kataros (Kotor), i mirëpriti ata me ngrohtësi duke u ofruar ndihmën e duhur. Megjithatë, në dorëshkrimin burimor për shqiptarët nën sundimin e Ahmetit në Shkodër dhe pas rrëzimit të tij nën Kurd Pashën, mbetet e papërfunduar.12
Përveç 150 familjeve, 49 të tjerë arritën më vonë në Zarë nëpërmjet Kastellnovos, ku u pritën ngrohtësisht nga guvernatori Grimani, ashtu edhe nga peshkopi Zmajeviq.13

Më në fund, më 1735 u krijua hapësirë për ta në Borgo Erizzo dhe Zemunik duke i ndaluar rreptësisht që ata të lëviznin nga një vend në tjetrin. Familjet që u vendosën në Zemunik, u asimiluan në popullsinë kroate dhe sot nuk mund të gjendet as edhe një gjurmë e gjuhës shqipe, madje edhe mbiemrat e tyre familjarë nuk tregojnë pothuajse asnjë ndikim shqiptar.14
Nga ana tjetër, ata në Borgo- Erizzo ruajtën identitetin e tyre shqiptar. Kjo u ruajt sepse kryepeshkopi Zmajeviq, kërkoi që martesat të mos bëheshin në lidhje farefisnore, por të martohen me fise të tjera shqiptare. Për më tepër ata morën nëpër kisha priftërinj që flisnin shqip dhe po ashtu predikimi të mbahej në gjuhën shqipe. Një kishë u ndërtua për ta më 1727, kurse një Rektorat u ngrit gjithashtu më 1737. 15
Borgo Erizzo, i cili kishte një popullsi prej 409 banorësh më 1756, më 1853 arritën në 900 banorë. Më 1880 arriti në 2000 banorë. Sot është një fshat dhe një famulli me 3194 banorë, çka tregon se popullsia është rritur më tepër në 606 anëtarë nga 31 dhjetori i vitit 1900.
Sipas fjalorit dalmat të vitit 1908, Borgo Erizzo kishte 384 shtëpi, 2573 të besimit katolik etj. Politikisht, shumica e shqiptarëve kanë marrë nënshtetësinë kroate, por gjuha e tyre amtare ishte dhe mbeti shqipja.
Për sa i përket emrave të familjeve të tyre, Talloci , më 1726, na i jep këto të dhëna: Gesgenovich (3), Marghiecevich (10), Matesich (1), Cielencovich (1), Lucich (1), gjithashtu Petar Vucca Gianova, Pere di Marco dhe Luca Prend. Më 1733; Vlagdan, Prento Stani,Kneunichi, Nichin, Luco,Prendi, Tamar -tinovich, Muzia, Popovich, Marusich, Pavlov Vucin Nica – Dobrez, Gioca – Giuchin, Gioca Ginon, Lecca, Sperz, Marcovr Toma,, Covaz, Tatua. Regjistri i tokës i vitit 1756 rendit emrat e mëposhtëm (ato të shtypura me shkronja të pjerrëta, janë ende të zakonshme sot): Bergelu, Bitri, Chiurcorich, Calmetich, Covacich Duca detto Ciova, Duca, Giuca, Jovi, Gelencovich.16
Kraste, Marsija, Marsuni, Nica, Nicagi, Petani, Pincich, Pezzi. Sco – pelja, Sestani, Smirn, Jochich, Vuva (Vukic), Vladagni, Zancovich.Këta emra janë shkruar sipas drejtshkrimit italian. Emigruesit nga Shqipëria kanë kaluar përmes portit të Antivarit e që ishte pika e fillimit të migrimit të tyre për në Borgo Erizzo. Veshja tradicionale e shqiptarëve të Borgo Erizzos dhe të Zemunikut, nuk ndryshon nga ajo e fqinjve të tyre dalmatë. Të rinjtë dhe vajzat shqiptare kanë një vështrim të hapur dhe tërheqës, por gratë lodhen shpejt si pasojë e punës së pareshtur. Ata janë një popull punëtorë dhe këmbëngulës që kultivojnë madje edhe copën më të vogël të tokës pjellore në terrene shkëmbore. Ata janë gjithmonë të lumtur; të rinj dhe të vjetër këndojnë këngët tradicionale të cilat i kanë ruajtur brez pas brezi. Ata e vlerësojnë shumë lidhjen e miqësisë (pobratimstvo- duke e marrë rolin e vëllait) dhe jeta e tyre familjare ishte gjithmonë në harmoni. Shqiptarët kishin dhunti për çdo punë.. Në Borgo Erizzo ka një shkollë fillore kroate dhe një italiane, një institut Fröbel si dhe kolegjin e përgatitjes së mësuesve të lidhur me një shkollë me konvikt. Ata janë të arsimuar në shkolla, në artizanatet e tyre janë shumë të aftë, veçanërisht të kërkuar si kryepunëtorë ndërtimi dhe janë gjithashtu tregtarë të shquar.
Në Zarë kasapët dhe tregtarët e verës janë pothuajse ekskluzivisht shqiptarë, po kanë edhe zeje të tjera. Femrat shqiptare thurnin shporta prej kashte për shishet maraschino etj.
Sipas Thalloczyit, shumica e këtyre i takonin besimit katolik. Është ineresant se Tallochy na jep të dhëna flet për emigrimin e shqiptarëve në fshatin Peroji të Istrës pranë Pulës (Poles).Sipas tij ata u vendosën atje midis viteve 1645 – 1647. Të shpërngulurit sipas autorit mes viteve 1705 – 1707 Gijustino da Riva, guvernator i Dalmacisë, vizitoi të shpërngulurit (arbanasit- arbëneshët) dhe krijoi lidhje të ngushta me ta.17
Megjithatë, duhet theksuar se veprimtaria e tij nuk ishte e shkëputur nga interesat politike të Monarkisë Austro-Hungareze. Në fund të shekullit XIX, Vjena zhvilloi një politikë më aktive ndaj çështjes shqiptare dhe Thallóczy ishte njëri nga studiuesit që morën pjesë në këtë proces.

Borgo Erizzo dhe programi i vetëdijes kombëtare

Një nga aspektet më interesante të veprimtarisë së Thallóczy-t lidhet me programin e hartuar për komunitetin shqiptar të Borgo Erizzo-s.
Sipas historianit bashkëkohor Krisztián Csaplár-Degovics, në fund të shekullit XIX Thallóczy përgatiti një program që synonte të zgjonte dhe të forconte vetëdijen kombëtare shqiptare në këtë vendbanim. Programi parashikonte gjithashtu nxitjen e një veprimtarie letrare, zhvillimin e gjuhës letrare dhe përpjekjet për njësimin e alfabetit shqip.
Prandaj, veprimtaria e Thallóczy-t kishte një karakter të dyfishtë: nga njëra anë, përmbante interesim shkencor për historinë dhe identitetin shqiptar; nga ana tjetër, ishte pjesë e një strategjie më të gjerë politike të kohës.

Gjuha arbëneshe dhe ruajtja e identitetit kulturor

Një ndër elementet më të rëndësishme të identitetit të arbëneshëve të Zarës ishte ruajtja e gjuhës shqipe. Gjuha përbënte jo vetëm mjet komunikimi, por edhe bartëse të kujtesës historike, traditave familjare dhe përkatësisë kulturore të komunitetit.
E folmja arbëneshe paraqet interes të veçantë për gjuhësinë shqiptare, sepse përmban elemente të vjetra të shqipes, të cilat lidhen me të folmet e trevave prej nga kishin ardhur paraardhësit e këtij komuniteti. Për këtë arsye, ajo përbën një burim të rëndësishëm për studimin e historisë së gjuhës shqipe dhe të zhvillimit të saj në kushtet e diasporës.18
Në këtë kontekst, interesimi i Thallóczy-t për arbëneshët nuk mund të kuptohet vetëm si interesim për një grup të shpërngulur shqiptarësh. Ai lidhej edhe me rëndësinë që kishte dokumentimi i gjuhës, i zakoneve dhe i vazhdimësisë historike të këtij komuniteti.

Traditat, zakonet dhe kujtesa historike e arbëneshëve

Identiteti i arbëneshëve të Zarës nuk u mbështet vetëm në gjuhë, por edhe në traditat familjare, zakonet shoqërore dhe kujtesën e prejardhjes.
Një rol të veçantë në ruajtjen e identitetit kishte kujtesa kolektive. Tregimet e të moshuarve për shpërnguljen, për paraardhësit dhe për vendbanimet nga të cilat kishin ardhur përbënin një formë të trashëgimisë historike që përcillej gojarisht.
Borgo Erizzo u shndërrua gradualisht në një vendbanim me identitet të dallueshëm brenda qytetit të Zarës. Arbëneshët morën pjesë në zhvillimin ekonomik, kulturor dhe shoqëror të qytetit, duke dhënë kontribut në fusha të ndryshme të jetës publike.

Proceset e asimilimit dhe transformimi i identitetit

Një nga çështjet më të rëndësishme në studimin e arbëneshëve të Zarës është procesi i transformimit të identitetit të tyre gjatë shekujve.
Vendosja në një mjedis të ri, marrëdhëniet me popullsinë vendëse, shkollimi dhe ndryshimet politike ndikuan në mënyrën se si komuniteti e ruajti dhe e përcaktoi përkatësinë e vet.
Për këtë arsye, studiuesit duhet të bëjnë dallimin ndërmjet prejardhjes etnike, përdorimit të gjuhës dhe identifikimit kombëtar. Këto tri kategori nuk janë domosdoshmërisht të njëjta dhe mund të ndryshojnë në periudha të ndryshme historike.
Studimi i Dragutin Babić dhe Šenol Selimović për kujtesën dhe identitetin etnik e kombëtar të arbëneshëve të Zarës ofron një pikënisje të rëndësishme për analizimin e këtyre proceseve.19

Rëndësia e veprimtarisë së Thallóczy-t për historiografinë shqiptare

Kontributi i Ludwig Thallóczy-t duhet vlerësuar në disa drejtime.
Së pari, ai ndihmoi në zgjerimin e njohurive mbi historinë e diasporës shqiptare dhe mbi vendbanimet shqiptare jashtë trojeve etnike.
Së dyti, përmes dokumentimit dhe studimeve të tij, ai kontribuoi në njohjen e arbëneshëve të Zarës si një komunitet me prejardhje shqiptare dhe me histori të veçantë migrimi e zhvillimi.
Së treti, veprimtaria e tij dëshmon rëndësinë e burimeve arkivore dhe të bashkëpunimit ndërmjet studiuesve të vendeve të ndryshme për rindërtimin e historisë së popujve të Ballkanit.
Kjo qasje na mundëson që Thallóczy-n ta trajtojmë jo vetëm si historian të rëndësishëm të Ballkanit, por edhe si një personalitet që kontribuoi në dokumentimin e historisë shqiptare në një periudhë të rëndësishme të zhvillimeve evropiane.

Përfundime

Studimi i jetës dhe veprimtarisë së Ludwig Thallóczy-t dëshmon rëndësinë e historiografisë evropiane në dokumentimin dhe njohjen e historisë shqiptare.
Interesimi i tij për arbëneshët e Zarës përbën një pjesë të rëndësishme të këtij kontributi, sepse përmes studimit të diasporës shqiptare ai ndihmoi në evidentimin e vendbanimeve, të prejardhjes dhe të vazhdimësisë kulturore të komuniteteve shqiptare jashtë trojeve të tyre.
Arbëneshët e Zarës janë shembull i qëndrueshmërisë së një komuniteti që, përkundër largimit nga vendi i origjinës dhe ndryshimeve të mëdha historike, arriti të ruajë për shumë breza elemente të rëndësishme të trashëgimisë shqiptare.
Veprimtaria e Thallóczy-t duhet parë në kontekstin e kohës së tij, duke marrë parasysh edhe lidhjen e studimeve të tij me interesat politike të Monarkisë Austro-Hungareze. Pikërisht kjo e bën të domosdoshme një qasje kritike dhe të argumentuar ndaj veprës së tij.
Në përfundim, mund të thuhet se studimi i arbëneshëve të Zarës nuk është vetëm një çështje e historisë së një komuniteti të diasporës, por edhe një pjesë e rëndësishme e historisë së përgjithshme shqiptare. Ai dëshmon se historia e një populli nuk ndërtohet vetëm brenda kufijve të trojeve të tij, por edhe përmes gjurmëve që brezat e tij kanë lënë në hapësirat e tjera evropiane.

Fusnotat:

1. Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", në Illyrisch-Albanische Forschungen, vëll. I, München–Leipzig: Duncker & Humblot, 1916. Për trajtimin e këtij studimi shih edhe Krisztián Csaplár-Degovics, Lajos Thallóczy and Albanian Historiography, Budapest, 2019, f. 123–124.
2.Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", po aty f.323
3., Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", po aty f.323
4. L. Thallóczy, K. Jireček dhe M. Šufflay, Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia, vëll. I–II, 1913–1918.
5. Edmond Malaj, "Rrethanat politiko-shoqërore të shpërnguljes së shqiptarëve në Zarë dhe krijimi i kolonisë së Borgo-Erizzos", Studime Historike, nr. 1, Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2024, f. 53–81.
6. Edmond Malaj, po aty, f. 77–78; të dhënat demografike të cituara nga Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", f. 328.
7. Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", në Illyrisch-Albanische Forschungen, 1916, Leipzig, f. 322; Krisztián Csaplár-Degovics, Lajos Thallóczy and Albanian

Historiography, në These were hard times for Skanderbeg, but he had an ally, the Hungarian Hunyadi, Budapest, 2019, f. 123–124.
8. Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", po aty, f. 323.
9. Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", po aty, f. 324.
10. Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", po aty, f.326
11. Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", po aty, f.327
12. Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", po aty, f.328. Për gjuhën dhe trashëgiminë e arbëneshëve shih Aleksandar Stipčević, Kulturno povijesni spomenici u Arbanasima (Zadar), Zadar, 1977. Për të folmen arbëneshe duhen konsultuar edhe studimet e veçanta dialektologjike mbi komunitetin e Zarës.
13. Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", po aty, f.328 Dragutin Babić dhe Šenol Selimović, "Zadarski Arbanasi: Sjećanje, etnički i nacionalni identitet", Anali Hrvatskog politološkog društva, vëll. 15, nr. 1, 2018, f. 179–198.
14. Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", po aty, f. 329
15. Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", po aty, f. 329
16. Ludwig Thallóczy, "Die albanische Diaspora", po aty, f. 330

Referencat

[1] Thallóczy, Ludwig, "Die albanische Diaspora", Illyrisch-Albanische Forschungen, vëll. I, München–Leipzig, 1916.
[2] Krstiq,Kruno, " Dosijeljenje Arbanasa u Zadar", Zadar, 1988.
[3] Henning, Klaus, " Die Albaner in Italien", Ostereichische Osthefte 7 Heft 2 Wien, 1965.
[4] Tullio, Erber, " La Colonia Albanese di Borgo Erizzo presso Zara, Raguza, 1883.
[5] Tagliavini, Carlo, " L'Albanese di Dalmazia", Firenze, 1937.
[6] Koliqi, Ernest, " Traduzioni populari degli Albanesi de'Italia", Roma, 1962
[7] Arbëneshët e Zarës, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2018.
[8] Weigrand, Gustav," Jahresbericht des Insituts fyr rumanische Sprache," Leipcig, 1911.
[9] Çurkoviq, Mijo, " Povijest Arbanasa kod Zadra", Shibenik , 1922.
[10] Aleksandër, Stipçeviq " Kultura tradicionale e arbëneshëve të Zarës", Prishtinë, 2012.
[11] Jokle, Norbert, "Zur Erforschung der albanischen Mundart von – Erizzo in Dalmazien", Firenze, Geneve I, 1940.
[12] Rela, Josip, "Arbëreshët e Zarës," Vepra II, Prishtinë, 1971.
[13] Krstiq, Kruno " Reçnik govora Zadarskih Arbanasa, Zadar, 1987.
[14] Miklosich, F. " Albanische Forchungen" , Wien, 1871.
[15] Aleksandër, Stipçeviq, Akademi shkencore, Prishtinë, 2018.
[16] Shkodra, Zija " Kontribut për historinë e diasporës shqiptare, Studime historike 3, Tiranë, 1971.
[17] Frashëri, K., Diaspora shqiptare mesjetare , në " Shpërngulja e shqiptarëve gjatë shekujve" , Libri1, Prishtinë, 1992.
[18] Qabej, Eqrem, " Shqiptarët në Itali, Zarë, Srem, Bullgari, Rumani, BRSS, Turqi, Egjipt, SHBA, në Italinë e Mesme dhe në Napoli në "Shpërngulja e shqiptarëve gjatë shekujve," Libri 1, Prishtinë, 1992.
[19] Novak, Grga" Presjek kroz povijest grada Zadra", Radovi sveska XI- XII, Zadar, 1965.
[20] Novak, Maja, " Zadar glavni grad mletaçke Dalmacije i Albanije, Radovi sveska XI- XII, Zadar, 1965.
[21] Trajliq, M. Seid " Zadar i Turska pozadina od XV do podkraja stoljeca", Raadovi sveska XI- XII, Zadar, 1965.
[22] Babinger, Franc," Mehmed der Eroberer Weltensturmer aeiner Zeitenwende I,II, Munih, 1987.
[23] Baliu, Begzad, "Studime për historinë e Albanologjisë," Shkup, 2018.
[24] Rolfus, Hermann Zeitfasen, " Allgemeinen Welltgeschichte", Freiburg, 1896.
[25] Bulle, Constantin, "Geschichte der Jahre 1871 bis 1877 , I, II" Leipzig , 1878.
[26] Neziri, Zeqirja, " Hrvati o Albancima, Zagreb, 1994.
[27] Enciklopedija Leksikografskog Zavoda Sveska 1, Zagreb, 1955.
[28] Csaplár-Degovics, Krisztián, Lajos Thallóczy and Albanian Historiography, Budapest, 2019.
[29] Malaj, Edmond, "Rrethanat politiko-shoqërore të shpërnguljes së shqiptarëve në Zarë dhe krijimi i kolonisë së Borgo-Erizzos", Studime Historike, nr. 1, 2024.
[30] Stipčević, Aleksandër, Kulturno povijesni spomenici u Arbanasima (Zadar), Zadar, 1977.
[31] Ajvazi, Murat " Çështja shqiptare në shtypin kroat" (1881 -1912), Prishtinë, 2012.

[32] Ajvazi Murat, " Kryengritjet shqiptare (1911 –'12) dhe Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë sipas shtypit kroat", Prishtinë, 2016.
[33] Ajvazi, Murat " Skënderbeu në historiografinë zvicerane " Prishtinë, 2018.
[34] Ajvazi Murat, " Scanderbeg in Istoriografia Elvetana" , Amanda Edit Verlag, Bukuresht, 2019.
[35] Ajvazi Murat, " Skenderbeg u Shvajcarskoj Istorijografiji", Prishtinë, 2019.
[36] Ajvazi, Murat, "Skanderbeg in Swiss Istorijography" Verlag Ajvazi, Baden, Schweiz, 2021.
[37] Ajvazi, Murat, " Scanderbeg Dans L' Istorijographie, Suisse, Verlag Ajvazi, Baden, Schweiz, 2021.
[38] Ajvazi, Murat, "Scanderbeg Nella Storijografija Svizzera", Verlag Ajvazi, Baden, Schweiz, 2022.
[39] Ajvazi , Murat, " Skenderbeg I Schweizisk Historiografi", Erik Hans, Boras, Svenska (Suedi), 2022.
[40] Ajvazi Murat, "Beteja në Fushën e Dardanisë e vitit 1389 në burimet historike gjermanofolëse" Verlag Ajvazi, Baden, Schweiz, 2024

Revistat:

- Radovi, Zadar
- Zbornik odseka za povijesne znanosti Zavoda za povijesne i drushtvene znanosti Hrvatske Akademije Znanosti i Umjetnosti, Zagreb.
- Povijesni prilozi , Hrvatski Institut za Povijest, Zagreb.
- Çasopis za suvremenu povijest Institut za Povijest, Zagreb
- Gjurmë historike, botim i Lidhjes së Historianëve Shqiptarë në Botë me seli në Zvicër.
- Studime historike, Tiranë.